



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
**SHËRBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 794 Prot

Tiranë, më 10/06/2022

**URDHËR**

Nr. 10 datë 10/06/2022

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE ON-LINE NGA SHËRBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR**


**Në zbatim të:**

1. Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
2. Ligjit Nr. 107/2021, datë 04.11.2021 “Për bashkëqeverisjen”.
3. VKM Nr. 252, datë 29.04.2022 “Procedura e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të tyre”;
4. Urdhrit të Kryeministrit, Nr. 153 Prot., datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data 01.01.2020”;
5. Udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Nr.10, datë 20.04.2022 “Për përcaktimin e procedurës, llojit dhe për dhënien e shërbimeve on-line të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”;
6. Udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Nr.11, datë 20.05.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 10, datë 20.04.2022, “Për përcaktimin e procedurës, llojit dhe për dhënien e shërbimeve on-line të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”;

**Urdhëroj:**

1. Miratimin e “Rregullores për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Kjo rregullore u bëhet e njohur të gjithë punonjësve të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, të cilët janë të detyruar për ta zbatuar sipas funksioneve të tyre.
3. Për zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohet Drejtoria e Programim-Zhvillimit dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.
4. Urdhri Nr. 7, datë 17.05.2022 “Për miratimin e rregullores për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar”, shfuqizohet.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**  
**DR. VIKTOR DODA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
**SHËRBIMI GJEOLGJIK SHQIPTAR**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

**RREGULLORE**

**PËR PROCEDURAT E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE ON-LINE NGA  
SHËRBIMI GJEOLGJIK SHQIPTAR**

Miratuar me urdhër nr...*10*..... datë *10.10.6* / 2022

Përgatiti

A. Pambuku

N. Gjapi

M. Kenga

E. Prendi

**MIRATOI**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**DR. VIKTOR DODA**



Tiranë, Qershor 2022

## RREGULLORE

### “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar”

#### Në zbatim të:

1. Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
2. Ligjit Nr. 107/2021, datë 04.11.2021 “Për bashkëqeverisjen”.
3. VKM Nr. 252, datë 29.04.2022 “Procedura e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të tyre”;
4. Urdhrit të Kryeministrit, Nr. 153 Prot., datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data 01.01.2020”;
5. Udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Nr.10, datë 20.04.2022 “Për përcaktimin e procedurës, llojit dhe për dhënien e shërbimeve on-line të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”;
6. Udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Nr.11, datë 20.05.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr.10, datë 20.04.2022, “Për përcaktimin e procedurës, llojit dhe për dhënien e shërbimeve on-line të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”;

#### HYRJE

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, Nr. 153 Prot., datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data 01.01.2020”, një pjesë e aplikimeve për shërbimet që ofron Shërbimi Gjeologjik Shqiptar realizohen vetëm on-line përmes portalit “e-Albania”.

Në këtë Rregullore përshkruhet procesi trajtimit të shërbimeve on-line të ofruara nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar që në momentin e aplikimit deri në kthimin e përgjigjes për të Tretët.

#### SHKURTIME

**SHGJSH** – Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

**MIE** – Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

**AKSHI** – Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

**SQDNE** – Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik

**AMS** – Sistemi i regjistrimit dhe trajtimit të aplikimeve që bëhen nëpërmjet platformës “e-Albania”.

#### NENI 1

##### SHËRBIMET E DIXHITALIZUARA TË SHGJSH

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ofron nëpërmjet platformës qeveritare “e-Albania” shërbimet e

përcaktuara në **Udhëzimin e MIE, Nr.10, datë 20.04.2022 (Pika 1):**



1. Dhënie e dokumentacionit teknik gjeologo-minerar të arkivuar, etj.
2. Harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë.
3. Oponenca për studime gjeologjike, hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale.
4. Studime në fushën e Gjeoshkencës.

## NENI 2

### MËNYRA E APLIKIMIT

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, Nr. 153 Prot., datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data 01.01.2020” dhe VKM Nr. 252, datë 29.04.2022 (II, Pika 7) dhe Udhëzimin e MIE, Nr.10, datë 20.04.2022 (Pika 2), aplikimi për shërbimet e dixhitalizuara që ofron Shërbimi Gjeologjik Shqiptar realizohet vetëm on-line përmes portalit “e-Albania”.

Për kërkesat ndërinstitucionale për dokumentacion shoqëruar aplikimi bëhet nëpërmjet SQDNE (Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik).

Hapat e procedurës për të marrë shërbimet on-line nga SHGJSH janë përcaktuar në Udhëzimin e MIE, Nr.10, datë 20.04.2022 dhe Udhëzimin e MIE, Nr.11, datë 20.05.2022, si vijon:

Emërtimi i shërbimit	Hapat e procedurës
Dhënie e dokumentacionit teknik gjeologo-minerar të arkivuar, etj	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Identifikimi si qytetar ose biznes në portalin “e-Albania”;</li> <li>2. Zgjidhet shërbimi “Dhënie e dokumentacionit teknik gjeologo-minerar të arkivuar”;</li> <li>3. Klikohet butoni “Përdor”;</li> <li>4. Plotësohet formulari elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular;</li> <li>5. Konfirmohet pagesa.</li> <li>6. Njoftimi bëhet me e-mail dhe tek seksioni “Dokumentet e mia” në “e-Albania” rreth shërbimit të kërkuar.</li> </ol>
Harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Identifikimi si qytetar ose biznes në portalin “e-Albania”;</li> <li>2. Zgjidhet shërbimi “Harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë”;</li> <li>3. Klikohet butoni “Përdor”;</li> <li>4. Plotësohet formulari elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular;</li> <li>5. Konfirmohet pagesa.</li> <li>6. Njoftimi bëhet me e-mail dhe tek seksioni “Dokumentet e mia” në “e-Albania” rreth shërbimit të kërkuar.</li> </ol>
Oponenca për studime gjeologjike, hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Identifikimi si qytetar ose biznes në portalin “e-Albania”;</li> <li>2. Zgjidhet shërbimi “Oponenca për studime gjeologjike, hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale”;</li> <li>3. Klikohet butoni “Përdor”;</li> <li>4. Plotësohet formulari elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular;</li> <li>5. Konfirmohet pagesa.</li> <li>6. Njoftimi bëhet me e-mail dhe tek seksioni “Dokumentet e mia” në “e-Albania” rreth shërbimit të kërkuar.</li> </ol>



Studime në fushën e Gjeoshkencave	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Identifikimi si qytetar ose biznes në portalin “e-Albania”;</li> <li>2. Zgjidhet shërbimi “Studime në fushën e Gjeoshkencave”;</li> <li>3. Klikohet butoni “Përdor”;</li> <li>4. Plotësohet formulari elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular;</li> <li>5. Konfirmohet pagesa.</li> <li>6. Njoftimi bëhet me e-mail dhe tek seksioni “Dokumentet e mia” në “e-Albania” rreth shërbimit të kërkuar.</li> </ol>
-----------------------------------	---

Dokumentacioni i nevojshëm për të marrë shërbimet on-line nga SHGJSH është përcaktuar në Udhëzimin e MIE, Nr.10, datë 20.04.2022, si vijon:

Emërtimi i shërbimit	Dokumentacioni i nevojshëm
Dhënie e dokumentacionit teknik gjeologo-minerar të arkivuar, etj	Për këtë shërbim nuk nevojitet dokumentacion shoqërues.
Harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë	Për këtë shërbim nuk nevojitet dokumentacion shoqërues.
Oponenca për studime gjeologjike, hidrogeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studimi dhe materiali grafik që kërkohet t'i bëhet oponenca sipas rastit;</li> <li>2. Harta dhe material tjetër grafik shoqërues i studimit.</li> </ol>
Studime në fushën e Gjeoshkencave	Për këtë shërbim nuk nevojitet dokumentacion shoqërues.

### NENI 3

#### TRAJTIMI I APLIKIMEVE

Bazuar në Nenin Nr. 61 të Ligjit “Për Bashkëqeverisjen”, Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE) dhe VKM Nr. 252, datë 29.04.2022, “Procedura e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimitarisë administrative të tyre” (II, Pika 4, 6,7, 11, 12 dhe 14):

1. Ndërveprimi i SHGJSH me subjektet kërkuese, si dhe vendosja në dispozicion të tyre e dokumentit elektronik kryhen nëpërmjet platformës “e-Albania”. SHGJSH është e detyruar t’i vendosë ato në dispozicion subjekteve kërkuese, në formën e dokumentit elektronik, me nënshkrim ose vulë elektronike (sipas llojit të dokumentit dhe nënshkrimit të kërkuar), nëpërmjet platformës së sipërpërmendur.
2. SHGJSH është i detyruar të administrojë kërkesat për shërbim nëpërmjet platformës “e-Albania”.
3. Në rast se pranë SHGJSH paraqiten kërkesa për shërbim në rrugë postare në formën e dokumentit shkresor apo nëpërmjet postës elektronike, shërbimi nuk realizohet por njësia përgjegjëse e administrimit të aplikimeve on-line të SHGJSH i kthen përgjigje kërkuarit, në rast se ky i fundit ka adresë të saktë, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, duke e udhëzuar ta paraqesë kërkesën nëpërmjet platformës “e-Albania”.



4. Shërbimi i vendoset në dispozicion kërkuarit, brenda afatit përkatës, në formën e dokumentit elektronik me nënshkrim ose vulë elektronike, duke ia përcjellë platformës “e-Albania”, në sesionin “hapësira ime”. Në këto raste, afati i shkëmbimit të dokumenteve shoqëruese në sistemin nga e nesërmeja e momentit kur vlerësohet se detyrimi financiar është përcjellë në sistem.
5. Nëpunësi i ngarkuar për administrimin e aplikimeve ndërinstitucionale në SQDNE, për SHGJSH, është i detyruar që kërkesën për ndihmë administrative për kryerjen e një ose disa veprimeve të nevojshme, veçanërisht për njohjen me dokumente, fakte apo mjete të tjera të provës, në administrim të organit tjetër, sipas përcaktimit të nenit 71, të Kodit të Procedurës Administrative, ta dërgojë jo më vonë se 1 (një) ditë pune nga paraqitja e kërkesës nga kërkuari. Në çdo rast, ndihma administrative, sipas kësaj pike, kërkohet nëpërmjet SQDNE-së.
6. Njësia përgjegjëse e administrimit të aplikimeve on-line të SHGJSH, komunikimin për shkëmbimin e dokumenteve shoqëruese të kërkuara ndërmjet institucioneve për ofrimin e shërbimit, aplikimi i të cilit realizohet nëpërmjet platformës “e-Albania”, në sesionin “hapësira ime”, e realizon nëpërmjet SQDNE-së.

#### NENI 4


#### AFATET

**Bazuar në VKM Nr. 252, datë 29.04.2022 (II, Pika A8)**, afati i institucionit shtetëror për realizimin e shërbimit, në kuptim të neneve 56 dhe 57 të Kodit të Procedurave Administrative, llogaritet dhe fillon të numërohet pas ditës kur kërkuari ka paraqitur kërkesën në platformën “e-Albania”. Ndërsa **(II, Pika A9)**, afati i zbatueshëm për realizimin e shërbimit nga institucioni shtetëror është ai i përcaktuar në legjislacionin e posaçëm që rregullon veprimtarinë e tij dhe procedurën administrative konkrete.

Afatet e ofrimit të shërbimeve on-line për Shërbimin Gjeologjik do të jenë ato të përcaktuar në **Udhëzimin e MIE, Nr.10, datë 20.04.2022** “Për përcaktimin e procedurës, llojit dhe për dhënien e shërbimeve on-line të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar” dhe **Udhëzimin e MIE Nr.11, datë 20.05.2022** “Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr.10, datë 20.04.2022, “Për përcaktimin e procedurës, llojit dhe për dhënien e shërbimeve on-line të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”.

1. Afatet për ofrimin e shërbimeve on-line nga SHGJSH janë si vijon:

Emërtimi i shërbimit	Afati i ofrimit të shërbimit
Dhënie e dokumentacionit teknik gjeologjiko-minerar të arkivuar, etj	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ 5-10 ditë pune, pas konfirmimit të pagesës, për studimet pa llogaritje rezervash</li> <li>▪ 20-30 ditë pune, pas konfirmimit të pagesës, për studimet me llogaritje rezervash</li> </ul>
Harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë	5-10 ditë pune
Oponenca për studime gjeologjike, hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale	30 ditë pune, pas konfirmimit të pagesës



Studime në fushën e Gjeoshkencave	30 -90 ditë pune, pas konfirmimit të pagesës
-----------------------------------	--

Në rastin kur për SHGJSH do të dixhitalizohen shërbimet e tjera *on-line* (**Neni 1**), në mungesë të përditësimit të **Udhëzimit të MIE, Nr.10, datë 20.04.2022** “Për përcaktimin e procedurës, llojit dhe për dhënien e shërbimeve *on-line* të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar” dhe **Udhëzimit të MIE Nr.11**, datë 20.05.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr.10, datë 20.04.2022, “Për përcaktimin e procedurës, llojit dhe për dhënien e shërbimeve *on-line* të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”. , për këto shërbime do të zbatohen afatet e përcaktuara në VKM Nr. 252, datë 29.04.2022 “Procedura e ofrimit të shërbimeve *on-line* nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të tyre”, (**II, Pika A10-a,b,c**).

2. Afatet për plotësimin e dokumenteve shtesë/informacion sqarues për aplikimet që bëhen në platformën *e-Albania*” përcaktohen si vijon:

Emërtimi i shërbimit	Afati për		
	Informacion sqarues mbi aplikimin	Saktësim/ plotësim dokumentacioni shoqërues	Konfirmimin e pagesës nga subjekti kërkues
Dhënie e dokumentacionit teknik gjeologo-minerar të arkivuar, etj	5 ditë kalendarike	-	5 ditë kalendarike
Harta të komponentëve të ndryshëm gjeologjikë	5 ditë kalendarike	-	5 ditë kalendarike
Oponenca për studime gjeologjike, hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike, ambientale	5 ditë kalendarike	10 ditë kalendarike	5 ditë kalendarike
Studime në fushën e Gjeoshkencave	10 ditë kalendarike	-	5 ditë kalendarike

Në rastet kur subjekti kërkues nuk përgjigjet brenda afateve të përcaktuara njësia përgjegjëse e administrimit të aplikimeve *on-line* të SHGJSH që bëhen nëpërmjet platformës “*e-Albania*”, anulon (refuzon) aplikimin.

3. Afatet për trajtimin e kërkesave ndërinstitucionale nëpërmjet SQDNE janë përcaktuar në VKM Nr. 252, datë 29.04.2022 (**II, Pika B19**):

SHGJSH në rastin kur merr kërkesa për dokumentacion shoqërues nga institucionet kërkuese, ka detyrimin t’u vendosë atyre në dispozicion në SQDNE dokumentet shoqëruese të kërkuara, brenda afatit të përcaktuar në ligjin përkatës ose, në mungesë të tij, **brenda 2 (dy) ditëve punë nga e nesërmja e marrjes së kërkesës** për dokumentet shoqëruese në sistem.

Shërbimi i vendoset në dispozicion kërkuesit, brenda afatit përkatës, në formën e dokumentit elektronik me nënshkrim ose vulë elektronike, duke ia përcjellë platformës *e-Albania*”, në sesionin “hapësira ime”. Në këto raste, afati i shkëmbimit të dokumenteve



shoqëruese në sistem nis nga e nesërmja e momentit kur vlerësohet se detyrimi financiar është përcjellë në sistem.

## NENI 5

### NJËSIA PËRGJEGJËSE

Njësia përgjegjëse e për trajtimin e aplikimeve për menaxhimin e backendit AMS si dhe sistemit SQDNE për SHGJSH është Sektori i Emergjencave dhe Aktivitetit me të Tretët-Drejtoria e Programim-Zhvillimit. Përdoruesit janë përcaktuar sipas hierarkisë së mëposhtme:

#### Për AMS:

1.	Specialist	Specialist i Sektorit të Emergjencave dhe Aktivitetit me të Tretët
2.	Monitorues	Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave dhe Aktivitetit me të Tretët

#### Për SQDNE:

1.	Specialist	Specialist i Sektorit të Emergjencave dhe Aktivitetit me të Tretët
2.	Pritës	Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave dhe Aktivitetit me të Tretët
3.	Monitorues	Drejtori i Drejtorisë së Programim-Zhvillimit

Bazuar në VKM Nr. 252, datë 29.04.2022 (II, Pika B13, 15, 16, 17 dhe 18):

1. Detyrimi i nëpunësit të administratës shtetërore, për mundësimin e dokumenteve në SQDNE nis në momentin e marrjes së kërkesës për dokumentacionin shoqërues nëpërmjet SQDNE-së.
2. Shkëmbimi i dokumenteve dhe komunikimi ndërmjet institucioneve kryhen vetëm nëpërmjet SQDNE-së, në të cilin kanë akses punonjësit e administratës shtetërore, të caktuar për ndjekjen e procesit.
3. Në rastet kur punonjësi i caktuar, për shkak pamundësie apo kryerjes së pushimeve vjetore të pagueshme apo pushimeve të tjera me ose pa pagesë, nuk është prezent në punë, institucioni duhet të marrë masa për personin zëvendësues, i cili akseson sistemin me kredencialet e tij, me qëllim respektimin e afateve të shërbimit.
4. Aksesimin në sistem i punonjësit të administratës bëhet nëpërmjet kredencialeve personale, duke bërë të mundur identifikimin e tij në sistemin SQDNE, sipas legjislacionit që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.
5. Dokumentet e hedhura në SQDNE nga punonjësi i administratës duhet të jenë të ngarkuara në këtë sistem sipas formatit të zyrtarizuar, të jenë të nënshkruara elektronikisht ose të pajisura me vulë elektronike, në varësi të dokumentit. Dokumentet, të cilat janë të ngarkuara në SQDNE dhe rezultojnë të përfunduara kanë të njëjtën vlerë me dokumentet e lëshuara në formën e shkresës fizike nga institucioni.





## NENI 6

### KOSTOT

Kostot e shërbimeve on-line që SHGJSH ofron nëpërmjet platformës “e-Albania” janë specifike sipas dokumentit gjeologjik të kërkuar, bazuar në tarifatat e përcaktuara në **Udhëzimin e përbashkët me Nr. 5105/5, datë 19.08.2021 dhe 11557/3, datë 31.08.2021** të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për shërbimet me të tretët që kryhen nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar”.

## NENI 7

### MONITORIMI

Monitorimi do të kryhet sipas përcaktimeve në **VKM Nr. 252, datë 29.04.2022 (III, Pikat 23-25)**.

1. Në mënyrë që të zbatohen afatet për shërbimin ndaj kërkuar, nëpunësit, monitorimi për të verifikuar statusin e kërkesës do të bëhet nga eprori apo titullari nëpërmjet sistemit dhe sipas përcaktimit të hierarkisë së përdoruesve për sistemin SQDNE (specialist, pritës, monitorues).
2. Çdo nëpunës përgjegjës për administrimin e aplikimeve online nëpërmjet platformës “e-Albania” duhet të vetëdeklarohet, nëpërmjet sistemit, ofrimin e shërbimit ose statusin e kërkesës, duke përfshirë dhe datën në të cilën është ofruar ky shërbim te qytetari ose subjekti që ka paraqitur kërkesën.
3. Njësia përgjegjëse e administrimit të aplikimeve on-line të SHGJSH, që bëhen nëpërmjet platformës “e-Albania”, raporton periodikisht për statusin e aplikimeve dhe zbatimin e afateve të përcaktuara për shërbimet online në VKM Nr. 252, datë 29.04.2022 dhe Udhëzimin e MIE, Nr.10, datë 20.04.2022, tek titullari.
4. Njësia përgjegjëse e SHGJSH për administrimin e aplikimeve online nëpërmjet platformës “e-Albania” raporton pranë Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje për vonesat, kërkesat e refuzuara apo gabimet gjatë procesit për kërkim dokumentacioni, ofrimin e shërbimit dhe masat e marra nga institucioni në rast vonese në ofrimin e shërbimit.
5. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje është institucioni përgjegjës për monitorimin e raportimin e zbatimit të afateve dhe përdorimit të SQDNE-së, në rastet kur duhet të ketë shkëmbim dokumentacioni shoqëruar ndërmjet institucioneve deri në ofrimin e shërbimit dhe të dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik në platformën “e-Albania”, sipas afateve ligjore.

## NENI 8

### SHKELJET DHE PASOJAT

Në rast të shkeljes së afateve dhe mos ofrimit të shërbimit on-line të kërkuar nga njësia përgjegjëse e administrimit të aplikimeve on-line të SHGJSH dhe në rast ankese nga subjekti



kërkues (VKM Nr. 252, datë 29.04.2022; IV, Pika 29), masat përkatëse do të merren bazuar në **VKM Nr. 252, datë 29.04.2022 (III, Pika 27)**.

Mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim përbën kundërvajtje administrative dhe trajtohet sipas përcaktimeve të nenit 56, të ligjit nr.107/2021, "Për bashkëqeverisjen", duke nisur procedurën e inspektimit. Në përfundim të inspektimit, në rast se konstatohen shkeljet e afateve dhe të procedurave të përcaktuara në këtë vendim, ndaj punonjësit apo nëpunësit përgjegjës të administratës dhe/ose titullarit të institucionit merren masat e parashikuara në dispozitën e sipërpërmendur të ligjit nr.107/2021.

## NENI 9

### ADMINISTRIMI I DOKUMENTACIONIT

Klasifikimi i dokumentacionit të aplikimeve on-line nëpërmjet platformës "e-Albania" dhe ruajtja e tij, bëhet sipas legjislacionit në fuqi, metodologjisë së përpunimit të dokumentacionit dhe ruajtjes së tij (një kopje fizike dhe një kopje dixhitale).

Afati i ruajtjes së këtyre dokumentacioneve do të bëhet bazuar në nenin 7 pika 1 të Ligjit Nr.9154, date 06.11.2003 "Për Arkivat" si dhe në nenet 32, 33 të "Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë". Komisioni i Ekspertizës i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH-së), i cili ngrihet me Urdhër të brendshëm të institucionit, shqyrton dhe miraton listën dhe afatin e ruajtës së dokumentacionit sipas kategorive përkatëse.

## NENI 10

### TË TJERA

Në zbatim të VKM Nr. 252, datë 29.04.2022 (IV, Pika 28 dhe 30):

1. SHGJSH do të dorëzojë pranë AKSHI-t informacionin lidhur me shërbimet që akoma nuk ofrohen vetëm online (emërtimi, formulari i aplikimit, dokumentacioni shoqërues dhe përshkrimi), në mënyrë që AKSHI të marrë masa për realizimin e zhvillimeve të tyre teknike për përfshirjen e tyre në platformë, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 61, të ligjit nr. 107/2021, "Për bashkëqeverisjen".
2. SHGJSH përpiloi këtë rregullore të brendshme që përshkruan mënyrën e zbatimit nga ana e punonjësve që administrojnë aplikimet në platformën "e-Albania" si dhe strukturave të tyre përgjegjëse, të detyrimeve që burojnë nga kjo VKM.

## NENI 11

### MIRATIMI I RREGULLORES

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe bëhet e detyrueshme për zbatim.



**NENI 12**

**DISPOZITA TË FUNDIT**

Kjo rregullore u bëhet e njohur të gjithë punonjësve të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, të cilët janë të detyruar për ta zbatuar sipas funksioneve të tyre dhe hyn në fuqi menjëherë.

**MIRATOI**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**DR. VIKTOR DODA**



Tiranë, më 10 / 06 / 2022